**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË TË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR**
**SHBB "ILDI PAJTONI"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 38, datë 05.04.2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor" si dhe ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për qëndrën kombëtare të regjistrimit" i ndryshuar, sot në datë 04/02/2025, hartohet ky akt themelimi prej anëtarëve tëshoqërisë së bashkëpunimit bujqësor "ILDI PAJTONI".

Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, jo politike dhe e pavarur, me përbërjen e mëposhtme:

1. Z. Mentor Pajtoni, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, me date 13/11/1971, identifikuar me leternjoftimin me nr 036165179 dhe nr personal H11113037R, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar.
2. Znj. Dhurata Pajtoni, shtetase shqiptare, lindur ne Krujë, me date 29/11/1976, identifikuar me leternjoftimin me nr 032951467 dhe nr personal H66129041C, madhore me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar,
3. Znj. Fatmire Ajazi, shtetase shqiptare, lindur ne Mazhë Madhe, me date 05/02/1956, identifikuar me leternjoftimin me nr 035540184 dhe nr personal F65205058N, madhore me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar,
4. Z. Shaban Pajtoni, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, me date 31/07/1990, identifikuar me leternjoftimin me nr 033256377 dhe nr personal J00731073F, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar,
5. Z. Redion Pajtoni, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, me date 02/08/2001, identifikuar me leternjoftimin me nr 033562921 dhe nr personal K10802072S, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar,
6. Z. Gëzim Pajtoni, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, me date 13/06/1994, identifikuar me Pasaporten me nr BE8075773 dhe nr personal J40613063B, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar.
7. Z. Sefer Ajazi, shtetas shqiptar, lindur ne Bubq, me date 28/04/1953, identifikuar me leternjoftimin me nr 033094352 dhe nr personal F30428041M, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar.

**NENI 1**
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emërtimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor SHBB "ILDI PAJTONI" Inicialet e Shoqërisë do të jenë SHBB "ILDI PAJTONI". Shoqëria ka vulën

dhe logon e saj dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**NENI 2**
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së saj do të ketë:

- Mbjelljen, rritjen dhe përpunimin e të gjitha prodhimeve bujqësore që gjenden në territorin ku vepron shoqëria për të realizuar sasi më të medha prodhimi për të hyrë në treg për të arritur çmime më konkuruese për shitjen e tyre.
- Përmirësimin dhe organizimin e kultivimit të vreshtave, pemëve frutore dhe të produkteve bujqësore në përgjithësi, me qëllim rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit, si dhe për tregetimin e produkteve dhe nënprodukteve të tyre.
- Nxitjen dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve që kanë teë bëjnë me prodhimin dhe tregetimin e prodhimeve të fermerëve.
- Ngritjen e industrisë përpunuese, kryesisht ato që rriten bio në natyrë si dhe makazinimin, kultivimin, ruajtjen, përpunimin, paketimin, amballazhim dhe tregëtimin e tyre.
- Sigurimin dhe furnizimin e fermerve me impute cilësore dhe me çmime të favorshme.
- Mbarështimin e kafshëve blektorale të organizuar në ferma agroblektorale si gjedh, dhen, dhi, shpend, etj.
- Zhvillimin e agroturizmit në zonë dhe turizmit në përgjithesi duke shrytëzuar edhe resurse natyrale/ujore etj.
- Veprimtari në mbështetje të komunitetit për implementimin dhe menaxhimin e teknollogjive moderne të ujitjes të tokave bujqësore për përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe bujqësore si dhe mbështejta e personave me aftesi të kufizuar, dhe shtresave në nevoje duke përfshirë edhe shpërndmjen e ndihmave humanitare etj
- Dhënien e shërbimeve të projekteve në përgjithësi, konsulenca teknike, trajnime dhe çdo gjë të nevojshme për zhvillimin e territorit me pjesmarrës shoqërinë dhe/ose partnerë të jashtëm.
- Blerja, marrja me qira, manaxhimi i shërbimeve agro-mekanike, dhënia me qira ose qira kolektive e makinerive të nevojshme për aktivitetet e ortakëve apo të tretëve.
- Blerja ose marrja me qira e impjanteve për përpunimin, konservimin dhe transformimin e produkteve bujqësore për llogari të vetë, të ortakëve apo të treteve.
- Blerja, dhënia me qira, shitja, ndeërtimi apo marrja me qira të pasurive të paluajtshme në funksion të selisë qëndrore, magazinave, ofiçinave, rishitje e mjeteve teknike, mekanike, import-eksport, pajisje në përgjithësi.
- Realizimin dhe menaxhimin e zonave të gjelbra publike dhe private apo burimeve ujore.
- Shoqëria mund të kryej të gjitha aktet dhe negociatat juridike të nevojshme për realizimin e qëllimeve të saj.

- Shoqëria mund të ketë interesa dhe pjesmarrje në ndërmarrje të tjera nën çdo lloj forme kushtetuese, konsorciume, shoqata, me qëllim investimin e qëndrueshem dhe jo futjen në treg, me kusht, që të mos ndryshojë në mas të madhe objektin e përcaktuar nga statuti.

## NENI 3
## SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Tirane,Kashar, Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durres km 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Kati 4.
Veprimtaria e saj do të shtrihet në Njësinë Administrative Bubq, Bashkia Krujë si dhe kudo ku shtrihet anëtarësia e saj.

## NENI 4
## KOHEZGJATIA

Kohëzgjatia e veprimtarisë së shoqerise SHBB "ILDI PAJTONI", është e pakufizuar.

## NENI 5
## KAPITALI

- Kapitali i Shoqërisë përbëhet minimalisht 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributet e anëtarëve i cili është në Lekë.
- Kapitali ndahet në pjesë të cilat zotërohen nga anëtarët dhe përfaqësojnë vlerën e kontributit të tyre në kapital.
- Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazë të një rapoti vlerësimi të bërë nga një ekspert.
- Anëtarët janë pronarë të aseteve të tyre në kapitalin e shoqërisë duke qenë kështu dhe pronarë të Shoqërisë në raport me kontributet në kapital.
- Kapitali përkatës mund të shitet, dhurohet apo lihet trashëgimi nga secili prej anëtarëve të Shoqerisë.
- Kapitali mund të ndryshohet me anë të kontributeve shtesë të anëtarëve aktuale, me shtimin e numrit të anëtareve, me kapitalizmin e fitimeve apo me çdo mënyrë tjetër të ligjshme.

- Në momentin e krijimit të Shoqerisë, kapitali fillestarë është i ndarë si më poshtë:

| Nr | ID | Ortaket e shoqërisë | Numri i pjesëve | | Përqindja e pjesëmarjes | Kontribnti në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | H11113037R | Mentor Pajtoni | 1 | ( një pjesë) | 30.00% | 30,000 |
| 2 | H66129041C | Dhurata Pajtoni | I | ( një pjesë) | 10.00% | 10,000 |
| 3 | F65205058N | Fatmire Ajazi | 1 | ( një pjeseë | 10.00% | 10,000 |
| 4 | J00731073F | Shaban Pajtoni | I | ( një pjesë) | 10.00% | 10,000 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | K10802072S | Redion Pajtoni | 1 | ( një pjesë) | 20.00% | 20,000 |
| 6 | J40613063B | Gëzim Pajtoni | 1 | ( një pjesë) | 10.00% | 10,000 |
| 7 | F30428041M | Sefer Ajazi | 1 | ( një pjesë) | 10.00% | 10,000 |
| | Totali | | 7 | ( një pjesë) | 100.00% | 100,000 |

- Çdo anëtar ka detyrime të shlyejë plotësisht vlerën e kontributit të tij në momentin e anëtarësimit.

**NENI 6**
**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË MBAS TRANSFERIMIT**

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:
1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve; dhe
2. Administratori, i cili me vendim të Asamblesë mund të qëndrojë në detyrë për një periudhë kohe maksimalisht jo më shumë se 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori i miratuar nga mbledhja themeluese e Shoqerisë emërohet, Z. Redion Pajtoni, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, me date 02/08/2001, identifikuar me leternjoftimin me nr 033562921 dhe nr personal K10802072S, madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar, i cili ëmerohet Administrator për një periudhë 5 vjeçare nga data 04/02/2025 deri me 04/02/2030. Administratori ngarkohet me kryerjen e të gjitha procedurave të regjistrimit të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi

**NENI 7**
**MËNYRA E SHPËRNDARJES TË SHOQËRISË PAS TRANSFERIMIT**

Shoqëria shpërndahet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur nga Administratori.
Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në Statutin e Shoqërisë.
Shoqeria shpërndahet në këto raste:
a) Kur numri i antareve është nën shtatë veta.
b) Kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mudësi të përmbushet, pasi ka humbur aftësi pagese.
c) Në raste shpërndarjeje të shoqërisë, ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likujdim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Ky akt themelimi, hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në këtë ditë shoqëria njihet edhe si person juridik. Të drejtën e përfaqësimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të shoqërisë për të bërë regjistrimin e saj, e ka Administratori i saj.

**PËRFAQËSIA THEMELUESE**

**Mentor Pajtoni**

**Dhurata Pajtoni**

**Fatmire Ajazi**

**Shaban Pajtoni**

**Redion Pajtoni**

**Gëzim Pajtoni**

**Sefer Ajazi**